Kronikë

Durrës/ Plagosi të moshuarin për borxhin e pashlyer, në pranga 31-vjeçari

Policia e Durrësit ka vënë në pranga 31-vjeçari Adil Hizdri, i cili plagosi 70-vjeçarin, Fadil Hunda dje në një lokal, ndërsa arsyeja ka qenë një për borxh i pashlyer.



Redaksia
19 Korrik, 12:48 | **Përditesimi: 19 Korrik, 12:55**

Share

Detaje të reja kanë dal nga plagosja me armë në qytetin e Durrësit ditën e djeshme.

Policia e Durrësit ka vënë në pranga 31-vjeçari Adil Hizdri, i cili plagosi 70-vjeçarin, Fadil Hunda dje në një lokal, ndërsa arsyeja që ai ka qëlluar drejt të moshuarit duket se ka qenë një për borxh i pashlyer.

Personi tjetër i cili ishtë në vendin ku ndodhi ngjarja me inicialet A. T., që u shoqërua në polici më dhë pas në përfundim të veprimeve hetimore, u la i lirë.

LEXO EDHE:
Teatri 'Aleksandër Moisiu', rreth 5 mln euro për rikonstruksionin, ja si do ndryshojë

Sipas policisë 70- vjeçari, banues në Durrës, vijon të jetë në kujdesin e mjekëve.

> *Durrës*
>
> *Arrestohet në flagrancë 31-vjeçari që tentoi të vriste me armë zjarri pistoletë, një 70-vjeçar, dje në një lokal.*
>
> *Specialistët e Sektorit për Krimet e Rënda të DVP Durrës, në përfundim të veprimeve hetimore të kryera në drejtimin e Prokurorisë, për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes së ndodhur dje, rreth orës 19:30, në një lokal në lagjen nr.17, ku për shkak të një borxhi të pashlyer, mbeti i plagosur me armë zjarri pistoletë, shtetasi F. H., 70 vjeç, banues në Durrës, i cili vijon të jetë në kujdesin e mjekëve, arrestuan në flagrancë autorin e dyshuar të këtij rasti, shtetasin:*
>
> *A. H., 31 vjeç, banues në Shjak, për veprat penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyese dhe municionit".*
>
> *Arma e zjarrit pistoletë e dyshuar e përdorur për plagosjen u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.*
>
> *Shtetasi A. T., që u shoqërua dje, pas ngjarjes, në përfundim të veprimeve hetimore, u la i lirë.*
>
> *Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.*

S.B/Shqiptarja.com

TAG: Durres

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Jeni dakord që në Shqipëri të ndalohet përdorimi i euros për pagesa?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Durrës/ I dënuar me 6 vjet burg për tentativë vrasje, arrestohet 50-vjeçari (EMRI)
19 Korrik, 15:25

Durrës/ Vranë babanë dhe e groposën në kasolle, kryhet akt ekspertimi psikiatrik për tre fëmijët
Artur Korriku
19 Korrik, 12:29

Durrës/ Plagosi me armë 70-vjeçarin pas një konflikti të çastit, arrestohet 31-vjeçari
18 Korrik, 20:20

Durrës/ Aksidentoi një të moshuar për vdekje një muaj më parë, arrestohet 29 vjeçari dhe i vëllai (EMRAT)
18 Korrik, 14:58

Mbi 12.500 pasagjerë në 5 ditë në Portin e Durrësit, 26 sportele në shërbim! Kapiteni Allkaj: Në gusht pritet shtim fluksi
Aldo Mustafa
18 Korrik, 10:30

Intervista/ Rama e cilësoi si 'kampion të Rindërtimit', kreybashkiaku i Shijakut: Punuam pa pushim të ndihmonim familjet në nevojë! Heronj, punonjësit e administratës
17 Korrik, 16:15

Fushë-Krujë/ Kultivoi bimë narkotike, arrestohet 60 vjeçari
17 Korrik, 09:21

Kavajë/ Po lahej në plazhin e Golemit, mbytet 61-vjeçarja nga Sllovakia
16 Korrik, 20:41

Porti i Durrësit, 10 mijë shqiptarë e të huaj në vetëm 5 ditë
16 Korrik, 18:27

Nën akuzë për 'Falsifikim të dokumenteve' dhe 'Shpërdorim detyre', Prokuroria e Durrësit çon në gjyq punonjësit e Kadastrës së Kavajës
16 Korrik, 15:43



Aksidenti me motorr i merr jetën djalit të biznesmenit të njohur në Tiranë!
16 Korrik, 11:39

Krujë/ Shiste lëndë të dyshuar narkotike dhe mbante armë zjarri pa leje, në pranga 32-vjeçari
15 Korrik, 13:54

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje